



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 26

Datë: 06. 06. 2017, ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 20 dhe 21 /2017

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;
3. Aktivitetet e ZRPP-së;

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i opsioneve për anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve për saktësinë e numërimit të votave në Vendvotim;
5. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KOZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 20 dhe 21 /2017

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve, mirë se keni ardhur në mbledhjen e 26 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush diçka në lidhje me rendin e ditës?

Betim Gjoshi: Kryetare, vetëm shikoni edhe njëherë titullin e pikës së katërt, d.m.th., shqyrtim miratim i opsioneve për anëtarë të Këshillave të vendotimeve sasinë e numërimit. ndoshta shqyrtim i masave që duhet të ndërmerren për numërimin e saktë të votave në vendvotim.

Valdete Daka: Kush është për këtë rend të ditës? Faleminderit!

Komisioni miratoi rendin e ditës.

Valdete Daka: Pika e parë e shqyrtimit të miratimit të procesverbalit të mbledhjes së 20 dhe 21 a ka dikush vërejtje në këto dy procesverbale, nëse jo atëherë kush është për miratimin e tyre? Faleminderit!

Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve 20 dhe 21.

Vazhdojmë me pikën tjetër, e ajo është aktivitetet e sekretariatit. Po, urdhëro kryeshef!

- *Aktivitetet e sekretariatit*

Enis Halimi: Faleminderit! Sekretariati po vazhdon me përgatitjet konform planit operacional të të gjithave dimensionet e punës me qëllim implementimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e vitit 2017, pra për zgjedhjet e përgjithshme nga aktivitetet që vlen të theksohen është në vazhden e shtypjes së listave përfundimtare të votuesve pas përfundimit të certifikimit të listës votuese ka filluar shtypja e saj. Deri më tani ka përfunduar rreth 12 komuna. Pra, procesi i shtypjes ka përfunduar në 12 komuna. Për sa i takon votimit përmes postës, deri më tani kemi pranuar 45 pako me fletëvotime, të cilat janë duke u ruajtur në dhomën e sigurisë që ruhet nga policia 24 orë. Po ashtu, po vazhdon aktiviteti i trajnimit sipas agjendës, dhe në shumë komuna kemi bërë edhe monitorimin e tyre konform kërkesave që kanë qenë qoftë të shtruara këtu më herët dhe ato që kemi pas si nevojë për ta mbikëqyrë si proces të trajnimit. Është bërë po ashtu përgatitja e udhëzuesve të trajnimit për procedurat e pranim-dorëzimit e kështu me radhë. E kemi të paraqitur në formë tabelare në zhvillimin e trajnimit sipas komunave. Për sa i takon shtypjes të fletëvotimeve ka përfunduar si proces. Kemi informata se ka përfunduar si proces dhe tash janë në proces të paketimit. Pra këto fletëvotime për të përgatitur për transport edhe në qendër të numërimit të rezultateve ka filluar aktiviteti i trajnimit të stafit, qoftë për k-vote e në qoftë se stafit ditor që do të angazhohet për zgjedhjet dhe pjesën në vijim tjetër e keni pjesë e aktiviteteve e disa prej aktiviteteve administrative dhe të furnizimit përkatësisht statusin e këtyre kontratave. Faleminderit!.

Betim Gjoshi: E para, faleminderit për këto informacione që na ke ofruar por, nuk janë të rëndësishme për mua. Ndoshta një tabelë sikur kjo në faqen 3 është dashur me pas edhe për këtë aspektin se çka është marr në zotërim. Dhe jo vetëm çka është bërë në kontratë, edhe për mua kjo pika nën 5 për mos me bë kështu shqetësim më të madh me u shqetësuar se nuk është për një çështje që na duhet të dielën në kontratë se në bazë të ligjit kur mi prodhuar, kur me i ankimuar, bënë një zgjidhje se kjo është një prej elementeve të domosdoshme në vendvotim d.m.th. që nuk mund bëhet votimi pa to, këtu d.m.th. janë kryesore. Edhe për mua ishte informatë jo mirë kjo pjesa e diasporës, vetëm 45 pako.

Enis Halimi: Kryetare, a mundem? Është e vërtetë ndoshta i ka munguar raportit pjesa e detajeve se ku jemi me liferimin e këtyre materiale. Një pjesë e tyre ka filluar në depo që të procedohet, po vazhdon testimi i cilësisë së tyre. Ndoshta është lëshim në këtë raport por, nuk kemi dashur ta ngarkojmë me detaje që do të mund ta rëndonin si të tillë raportin. Edhe sa i përket pikës 5 që iu referuat, kemi pasur, është e vërtetë që për të gjitha kontratat kushtimisht po themi me qenë se është koha e shkurtër dhe natyra e tillë e punës mundohemi që të jemi të kujdesshëm në zbatim të atyre procedurave që detyrohemi ti zbatojmë në këto kondita të caktuara por, besojmë që do të ia dalim në kuptim që ti sigurojmë të gjitha materialet aq më tepër kur bëhet fjalë për ato që janë të rëndësishme pra janë të ndjeshme si kundër janë vultat.

Adnan Rrustemi: Përshëndetje të gjithëve! Po në fakt në vijimësi të asaj që u tha për neve është pak e rëndësishme se cili është statusi i kontratave. Ne jemi disa ditë para ditës së zgjedhjeve. Po na intereson cila është gjendja e këtyre materialeve të domosdoshme. A ka filluar printimi, apo a ka përfunduar printimi i formave? A janë siguruar kabinat? A janë siguruar llambat dhe materialet tjera? Dhe, a ka filluar printimi i listës përfundimtare të votuesve dhe kur pritët ardhja e fletëvotimeve në depon e KQZ-ës në këtë rast? S`e koha është shumë e shkurt natyrisht duhet mi siguruar në kuptimin duhet mi bo kontrollin e cilësisë para shpërndarjes. Unë i pata nja dy pyetje që nuk ndërlihet domosdoshmërisht këtë çka keni raportuar, megjithëse për trajnim e keni dhënë një informacion. Unë kam pyetje, çka ndodhë me këto rastet e komisionereve të munguar në trajnim?

Ne, tha z. Rrustemi, e dimë që nuk mundemi me ushtruar detyrën asnjë komisioner që nuk e ka ndjekur trajnimin, por a ka ndonjë plan alternativ sekretariati që të ju organizoj ndonjë trajnim të veçantë këtyre që kanë munguar apo zëvendësimi i tyre. Ideja është si do të sigurohet që rolet e tyre do të përmbushen nga zyrtarë, në këtë rast të trajnuar. Kjo është çështja. Dhe e dyta, dy çështje. Mendoj që sekretariati duhet me na sjellë dy udhëzime në bazë të praktikës së mëparshme, por njëri bëhet me i rëndësishëm në këto zgjedhje që ka të bëjë me rolet e komisionerëve, pozicionet e përcaktuara nga këto për secilin komisioner. Fakti që kemi në këto zgjedhje një formulë specifike të përbërjes së KVV-ve 3 2 2, në shumicën e vendvotimeve e bënë edhe më të veçantë edhe më të domosdoshme një ndarje shumë rigorozë të pozicioneve për me ruajt integritetin e zgjedhjeve, që mos me qenë në asnjë rast 2 komisioner të të njëjtin subjekt politik në linjë kisha me thanë që korrespondon me veprimtari për me pengu çfarëdo tentimin që

e dëmton procesin zgjedhor dhe e dyta mbase edhe në këtë udhëzim mund të përfshihet. Ne e kemi përfunduar një praktikë në zgjedhjet e fundit nëse nuk gaboj për mënyrën e administrimit të fletëvotimeve në vendvotim, ka qenë një praktikë në përputhje me praktikën e Këshillit të Venecias që fletëvotimet që pranohen në vendvotim me u vendos të gjitha mbi tavolinën e dhënësit të fletëvotimeve për mos me pas asnjë nevojë e as mundësi të këmbimeve ose të qarkullimi të dengjeve të fletëvotimeve, të gjithë a ato që janë në dispozicion të vendvotimeve vendosen në mënyre transparente mbi tavolinë dhe përdoren ditën e zgjedhjeve.

Betim Gjoshi: Kryetare? Sa i për ketë çështjes së ndarjes detyra nëpër Këshilla të Vendvotimit, ne ende në doracak dhe rregullore, i kemi që ende i ndanë kryesuesi i këshillit të vendvotimit po e kemi një praktikë dhe besoj e kemi një konsensus që këto detyra me u nda duke u bazuar që asnjë prej anëtarëve të njëjtit subjekt mos me qenë afër tjetrit. Kjo e bënë kontrollin më të lehtë. 5 detyra të dy ndihmëse i ndahen në atë mënyrë. Kryesues i takon njërit, ai kontrolluesi i radhës i takon tjetrit. Mandej identifikuesi njërit, dhënësi i fletëvotimit tjetrit, e kështu me rrallë. Me qëllim me pas një farë kontrole dhe me qenë sa ma transparente, dhe plus asaj vëzhguesit me qenë të njëjtin rast, d.m.th të njëjtin vend qysh kanë qenë. Me sa kujtoj unë, në doracak e kemi përmirësuar tani sepse ka qenë mbrapa për me ndjekë atë praktikë. Çështje që e kemi ose përparësi që e kemi bë ose avancimet në proceset e kaluara të zgjedhjeve është mirë me e u kanë standard, i morëm ose si morëm ne hapa si KQZ, sekretariati është dashtë me i kryer këto. Unë besoj që ka pajtim prej të gjithëve në këtë aspekt.

Adnan Rrustemi: Po pajtohem, por pak në këto zgjedhjet është ma specifike. Ideja është që po mundemi me filluar me rotacion. Subjekti të parë kontrolluesi i rreshtit, subjekti i dyti identifikuesin, i treti dhënësi i vendvotimeve. Por duhet të keni parasysh që të paktën kontrolluesi i rreshtit ose gishtrinjëve dhe identifikuesi në vendvotim mos me qenë asnjë rast i të njëjtit subjekt politik. Kjo është shumë e rëndësishme. Ai te dera e klasës dhe ai që identifikon në listë të votuesve nuk bën asesi me qenë i të njëjtit subjekt politik.

Valdete Daka: Po, kryeshef!

Enis Halimi: Faleminderit! Për këto çështje që u ngritën, d.m.th këto materiale që janë në listë këtu, janë të etiketuara si të përfunduara. Pra ka përfunduar aktiviteti prokurues i tyre, dhe jemi në rrugë për t'i siguruar këto. Disa prej tyre që janë të ndjeshme kanë ardhur në depo dhe jemi në proces te testimi. Me gjithë problemet që kemi pas në këtë kohë të shkurtër që t'i zhvillojmë, qoftë proceduralisht dhe qoftë liferimin e tyre dhe më pas dhe pas vlerësimin e cilësisë së tyre që të garantojnë një proces me integritet. Për sa i përket trajnimeve dhe mungesave këtu, ne po i kushtojmë në të kaluarën, mirëpo tash me një theks më të veçantë, që asnjë komisioner të mos mund të përfshihet në proces zgjedhorë të cilit i mungon trajnimi.

Pra, tha z. Halimi, duhet të kujdesemi për aq mundësi që çdo komisioner që përfshihet në proces zgjedhorë ta këtë trajnimin e duhur. Këto mungesa këtu janë te evidentuar në mënyrë që mos e lejojmë asnjë që mos të na infiltrohet si i tillë, pra si i pa trajnuar. Për këta që mbesin

eventualisht ta pa trajnuar ose që nuk e kanë ndjekë në ditën përkatëse trajnimit. Ne gjithmonë në të kaluarën, por dhe tani, organizojmë grupe tjera sepse nuk ka përfunduar procesi si i tillë, nëse nuk kanë mundur sot, një pjesë nesër, një grupe mund ta ndjekë nesër edhe pasnesër trajnimit. Mirëpo do kujdesemi që asnjë i pa trajnuar të mos mund të përfshihet në proces zgjedhor. Edhe për këto, për shpërndarjen e komisionereve në detyra nëpër pozicione të caktuara. Në këto që u tha këtu dhe në ato që janë standarde në zgjedhjet e 2014-së nën to nuk do të biem asnjëherë.

Valdete daka: A kemi pyetje tjera?

Betim Gjoshi: Temat që kemi me diskutuar sot, nën 4, për masat që do të merren, na ka vonuar sekretariati për një javë. E, do të ketë shumë efektin më të vogël, duke e pas parasysht se çka është mbas trajnimit. E kemi humbur një momentum si rezultat i vonesave të tyre.

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën e 3, aktivitetet e ZRPP-së.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve

Miradije Mavriqi: Faleminderit, kryetare! Të nderuar anëtar të KQZ-së, zyra ka përgatitur rekomandimin për akreditimin e vëzhguesve të grupit të 7. Ju njoftojmë se deri me datë 5 qershor janë procesuar aplikacionet e 18 e organizatave që kanë aplikuar për akreditim të vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës Janë 3 ambasadave, 2 të koalicioneve, 4 parti politike, 1 organizatë ndërkombëtare, 1 i institucionit shtetëror të huaj, 2 organizatave jo qeveritare vendore, 5 media me gjithsej 15,128 vëzhgues. Zyra konstaton se aplikacioni për akreditim është i kontrolluar dhe rekomandon akreditimin e organizatave të cilat ju i keni të listuara bashkangjitura në rekomandim, Faleminderit!

Adnan Rustemi: Faleminderit! Në fakt së pari kisha kërkuar prej drejtoreshës, që në momentin kur përfundon ky procesi i akreditimit vëzhguesve të na jep një informatë të përgjithshme për secilën organizatë vëzhguese, numrin e vëzhguesve të akredituar. E dyta, në fakt unë du me e shpreh një shqetësim. Ç'është e vërteta, unë i kuptoj rrethanat që janë krijuar në këto zgjedhje, mirëpo duhet me shprehë një shqetësim për numrin e madh të vëzhguesve, sidomos të dy koalicioneve në këtë rast. E kuptoj që ligji nuk e kufizon numrin për akreditim të vëzhguesve po megjithatë kur fletë ligji për numrin e vëzhguesve kemi dy momente kur e precizon atë, i pari është kur thotë që në një vendvotim nuk mundë të ketë me shumë se dy vëzhgues të një subjekti politik, dhe dyta kur flet se sa vëzhgues mund t'i ketë një subjekt politik në QNR.

Për mua, vuri në dukje z. Rustemi, praktikisht është që ky kufizim i pranisë së vëzhguesve në hapësirat zgjedhore qoftë në vendvotim qoftë në QNR, është një lloj kufizimi i tërthorët i numrit të vëzhguesve që mundën me akredituar një vëzhgues, plus 10%, ose 15%, ose 20% për me

kompensuar, kisha me thënë, ose mungesën në paraqitje në ditën e zgjedhjeve, ose zëvendësimin ose situatat që mundën me u krijuar por një numër po e zë prej 9000 vëzhguesve ose rreth 9000 vëzhguesve siç e kemi 8200 sot edhe është hera e tretë që e kemi për koalicionin PDK-AAK-NISMA nuk e di a do të kemi ende se veç po flas unë se ende nuk e kemi numrin përfundimtar i bie që e kemi rreth 4 vëzhgues për vendvotim edhe unë mendoj që akreditimi ose lëshimi i begjave në emër të KQZ-së për persona të caktuar mundet me na dëmtuar ditën e zgjedhjeve për procesin zgjedhor , krijon persona që mundet me pengu në korridore në oborre të qendrave të votimeve që nuk mundesh me i konsideruar si persona të pa autorizuar sepse kanë begjat e KQZ-së a në ndërkohë nuk mundën me qëndruar as në vendvotim, unë e kuptoj që janë munduar të krijojnë një farë bilanci por edhe bilanci ka pas hapsin me u krijuar duke e ruajt kushtimisht qatë frymën e ligjit që del në vendvotim dhe pjesa tjetër të nenit 10 ose 15% të rezultateve.

Betim Gjoshi: Ligji është e vërtete qe e ka një frymë që nuk e len me 2 në vendvotim por nuk e ka një kufizim sa mundet me akredituar po këto koalicionet e mëdha janë kryetare nuk mudem mi ndal edhe e treta që është më e rëndësi më shumë, faleminderit.

Adnan Rrustemi: Unë e ngrita si çështje në përgjithësi megjithëse kam pyetur te zyra edhe më interesoj numri i secilës listë , ideja është që mos me krijuar prani të njerëzve të cilët në ditën e zgjedhjeve kanë mu identifikuar si vëzhgues ndërkohë madje na e dimë që kryesuesi i vendvotimeve ka një përgjegjësi që me zvogëluar numrin e vëzhguesve për një subjekt politik në vendvotim në bazë të numrit ose të pranisë etj. Shto këto mundësi që diku nuk do të lejohen as nga 2 në kuptimin e numrit të madh të pranishmëve komisioner që kemi po ashtu 3DD që kemi, unë mendoj që mundet me na krijuar problem. Unë po e ngriti si shqetësim se me vendimet e KQZ-së mos po e dëmtojnë në ditën e zgjedhjeve.

Ilir Gashi: Nuk është mirë që me krijuar paragjykime në raport me ligjin , subjektet politike shfrytëzojnë të drejtën ligjore që i'u ka jep ligji e thotë sakte që s`munden me qenë ma shumë se 2 , por nuk i`u ndalon me bo as 10.000 nëse ata kanë kapacitet edhe me i pagur edhe me i marr e me i mbajtur te shpija kështu që rutinë nuk bën me krijuar, edhe me nënkuptuar, ligji nuk lejon as me nënkuptuar, por edhe qartë, po mendoj që nuk është mirë me paragjykuar dispozitat ligjore.

Ercan Spat: A ka pas në aplikime edhe refuzime? çfarë është përqindja edhe a po dihen numrat saktë?

Valdete Daka: Pas verifikimit, a ka pasur edhe persona që nuk janë rekomanduar për akreditim?

Miradije Mavriqi: Jo. Ne, kur dorëzohen listat prej organizatave ose subjekteve mundet me ndodh qe janë disa gabime teknike te cilat jonë p.sh numrat e lejes së njoftimit nuk përputhen me të dhënat, e kemi dorëzuar në shkresat d.m.th edhe atyre subjekteve ose organizatave të cilat në ndërkohë i kanë përmirësuar. Kështu që, ne nuk i kemi pas ndonjë kandidatë që është refuzuar për ndonjë arsye tjetër.

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare , besoj qe u shterur deri në fund debati rreth kësaj, por desha, sepse u përmend edhe koalicioni të cilin në këtë rast e përfaqësojnë Lidhjen Demokratike të Kosovës. Këtu edhe kjo pjesë sigurisht që në vendvotim nuk do të ketë më shumë se dy ashtu qysh e thotë ligji , problem i joni është qysh ne e rregullojmë në vendvotim. A i ndërrojmë çdo dy orë ose çdo katër orë a, unë do të kem ende vëzhgues, do të ketë ende që do të bëhen, por nuk do te jene ne vendvotim nëse bëjnë shkelje, problem i yni është që të rregullojmë në vendvotim, a i ndërrojmë, i qojmë me pushu, i ndërrojmë nuk dëshirojmë me i lë. Është çështje e jona, ligji nuk e ndalon prandaj, nëse atëherë përmbushen kriteret ligjore do të akreditohen si këta, ka ende se nuk janë vetëm këta , d.m.th formatin qysh e organizojmë në vendvotim është çështje e jona, por sigurisht nuk do të thuhet ligji, në çdo vend do të jetë maksimumi dy nga subjekti.

Valdete Daka: Faleminderit Bajram, është shumë e qartë mendoj se nuk kemi nevojë më tutje me diskutuar. Kush është për akreditimin e këtyre vëzhguesve? Faleminderit.

Komisoni miratoi këtë pikë të rëndit të ditës

Betim Gjoshi: Kisha një çështje, te vëzhguesit ka qenë në rregull p.sh. kur ka përfunduar afati të dielën me na tregu sa ka qenë numri i aplikimeve krejt d.m.th se KQZ-ja nuk mundet me pranuar pas të dielës aplikime përveç personave që bëjnë përmirësime. D.m.th kjo l ka qenë në rregull me dite, kemi edhe shumë që jemi tu i prite se është numri shumë i vogël se në të gjitha zgjedhjet që kemi pasur me këta çka kemi akredituar deri tani. A ka edhe shumë që janë duke pritur? Në qoftë se e dinë , në qoftë se nuk e dinë nuk është problem.

Valdete Daka: Po gjithsesi është numri më i vogël se zgjedhjet e kaluara, se herën e fundit i kemi pasur 36 mijë, po diku 20 mijë. 15 mijë deri më tani, me gjithë këto 20 mijë. Po se sot 15 mijë i kemi edhe 4 mijë e diçka i kemi akredituar deri dje, po sot janë 15 mijë. Vazhdojmë me pikën tjetër...!

4. Shqyrtimi dhe miratimi i opsioneve për anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve për saktësinë e numërimit të votave në Vendvotim

Enis Halimi: Faleminderit kryetare, ashtu si kundër kemi diskutuar në mbledhjet e kaluara dhe kanë dalë edhe si kërkesë dhe në funksion të transmetimit besnik, mesazhit përkatësisht vullnetit të qytetarëve për kandidatë përkatës ti nënshtrihen garimit në këto zgjedhje sekretariati ka paraqitur këtu para jush nja tri modele se si ne mendojmë që ta vëmë theksin tek komisionerët në lidhje me numërimin përgjithësisht dhe specifikisht për numërimin e votave të kandidatëve në mënyrë që ashtu si edhe kundër edhe njëherë përmenda vullneti i qytetarëve të adresohet në mënyrë besnike ashtu si kundër niset pra prej tyre. I keni tri dokumente para vetes njëra është që zgjedhjet qershor në formë të fletëpalosjes e cila ndërthen në vete numër të caktuar të

informatave të përgjithësuara dhe në frymën e, si kundër e do ky dokument pra duke e përfunduar me disa nene të kodit penal në fund të tij, për masat që i presin ata që e lakojnë si të themi vullnetin e zgjedhësve, versioni tjetër është një lloj deklarate në të cilën ne kemi menduar që të jetë me, nëse aprovet këtu të jetë me nënshkrim nga kryetarja e komisionit dhe atëherë kur këta i kanë trajnimet kryesuesit, tu prezantohet kryesuesve, tu jepet me vete dhe para hapjes së vendotimit ose edhe para nisjes së procesit të numërimit tash varet si e bëjmë, që kryesuesi ta merr për obligim tu a lexoj dhe tu bëjë edhe një herë me dije se për përgjegjësit e tyre që ata i kanë për procesin të votimit, e veçanërisht, në numërim.

Pra, theksoi z. Halimi, kjo është e menduar që sepse ju e dini që me kryesues e kemi edhe një trajnim të premtën dhe pra si të tillë kemi kohë mjaftueshëm që ta distrubuojmë në këtë nëpër qendra të trajnimit dhe po ashtu secili kryesues në vendotimin e caktuar ta merr një gjë të tillë. Propozimi i fundit është kodi penal dispozita që nenet përkatëse që flasin ekskluzivisht për cenimin e drejtës se votës përgjithësisht. Sa për informim edhe për rikujtim edhe njëherë, çdo komisioner para nënshkrimit edhe ditën kur fillon trajnimin kur e nënshkruan kontratën me ne, e nënshkruan kodin e mirësjelljes i cili përmban një mori zotimesh dhe disa vërejtje për përgjegjësit e tij ose disa nënvizime ta quaj se vërejtje ka konotacion tjetër në këtë kontekst, disa nënvizime për punën e tij për disa zotime në kuptimin etik të fjalës e kështu me radhë, pra komisionerët edhe deri më sot e kanë nënshkruar kodin e mirësjelljes si të tillë dhe po ashtu janë njoftuar më herët, i kemi pas edhe disa projekte që i kemi shpërnda këto te dispozitave të kodit penal si vërejtje për ta, e re kisha me than është kjo deklaratë se kryesuesit mund ta bëjnë edhe një herë d.m.th një lloj ripërkujtimi për përgjegjësinë e tyre dhe sjelljet e tyre etike që duhet ata ti kenë.

Betim Gjoshi: Faleminderit. Me treguar drejt unë i kam para këta këtu çka kanë punuar nuk i përmbushin ato që ne i kemi diskutuar dje , ju d.m.th të gjithë keni qenë në takimin dje ndoshta Adnani ka munguar këtu kanë qenë disa propozime dje që kemi bërë për masat për mbrojtjen e votës edhe numërimin e saktë të votave për subjekte politike edhe për kandidatët e atyre subjekteve politike. Ka qenë propozimi i parë që ne të angazhohemi në çdo vendotim rreth 2490 vendvotime sa kemi nga një zyrtarë shtetëror varësisht prej mënyrës së përzgjedhjes të cilën një pjesë e kolegëve kanë menduar që jemi vonë, ka qenë e dyta që ne të dërgojmë një deklaratë, udhëzues për përgjegjësit që kanë për numërimin e saktë të votave për subjekte edhe për vendvotime që mendoj për afërsisht i plotëson, i duhen disa shtesa, ka qenë e treta një shpërblim edhe ndëshkim që kemi propozuar për komisionet, këshillat e vendvotimeve, vendvotimet e rregullta me numërimin e votave, të kemi një bonos për ato këshilla të vendotimit ndërsa për pjesën tjetër ku kemi defekte gjatë ditës së zgjedhjeve përveç përgjegjësisë edhe i penalizojmë me një pjesë edhe për këtë pra është një propozim dhe e katërta ka qenë materiali edukues për rëndësinë që ka. Po ja filloj prej këtij të fundit materiali edukues as për afërt nuk e përmbush at që duhet me kanë e para shtypja e kodit penal nuk do të thotë asgjë se jo gjithë këshillat e vendvotimit munden me interpretuar këtë kod penal po duhet mi tregu theksin ku ne e kemi që ata me kuptuar bazë detyrave të veta që ata duhet të bëjnë, të bëjnë numrin të votave të sakta të

subjekteve, mos të falsifikojmë nënshkrime edhe gjitha çështjet që janë të zërthyer që me përfshirë se me qenë ma te bukura që me qëndruar, pamje kështu ilustrative duke i përfshirë edhe numrat në fund të policisë, prokurorisë, ata të tjerët që kanë ndonjë interes për me ankimuar ose me denoncuar njëjtë është edhe kjo fletushka kjo nuk e potencon askund çështjen që na e kemi me diskutuar, çështjen e votave për kandidatë realisht nuk e potencon askund çështjen e nenit 219 të kodit penal të Republikës së Kosovës.

Këtu, tha z. Gjoshi, ka qenë theksi dhe jo numërimi i saktë, i rezultateve ashtu si e që neni i falsifikimi i rezultateve të votimit pra për mu nuk i plotëson këto kritere që ne i kemi kërkuar si anëtar të komisionit zgjedhor është një përpjekje e mirë po ndalem mandej të deklarata të këshillat të vendvotimit, unë mendoj se duhet me u shtuar pika kryesore që këta duhet të punoj gjatë procesit të votimit dhe numërimit bazë të doracakut se problemi mbas të asaj që ne jemi duke shënuar sepse numëron secili komisioner votat e partive të veta dhe kjo është problemi pos doracakut e ka për detyrë që meny grupe për të i numëruar se qysh i kanë detyrat lexues, verifikues, shënues qysh i kanë ata në mënyrë transparente por është mirë qysh i kanë edhe ku nënshkruhet edhe qysh i kanë, sepse pagesa se qysh i kanë se varet prej në shkrimin e kësaj deklarate edhe askush për arsye në qoftë ti e detyron d.m.th këto janë ato çështje mendoj se në qoftë se ka gatishmëri nga kolegët në qoftë se ka me i plotësuar , pra propozimi i parë ka nga tash edhe vetë po bindemi se 1 javë kanë shkuar nga sekretariati , për këto 3 tjera mendoj që duhet me plotësuar nga këto elemente që thash shpërblimin që unë qëndroj mbrapa që na kemi mundësi me i shpërblyer se na veç një komunë me bo me përsëritur ose vetëm në 10 vendvotime na kushton ato munden edhe me u kompensuar atë ku ka probleme ndaleni po aq sa i shpërbleni këto tjerë mundeni me i sanksionuar në këtë mënyrë edhe në qoftë se ka mjete është fjala ose mundemi me lënë një bonos në qoftë se ka ose që shkon në rregull kemi me ju bonos mbas zgjedhjeve kursime mas zgjedhjeve për me bo këtë punë në qoftë se nuk jeni të sigurt për çështje buxhetore edhe materialin edukues për ta përgatitur më seriozisht dhe kjo është total ma serioze kemi edhe kompani kontraktuese që e ka marr edhe shumë më të madhe të buxhetit është mirë me e përdor edhe për dizajn edhe për çështje të tjera.

Enis Halimi: E kemi diskutuar edhe në kontekst buxhetor edhe këtë iden e dytë që prezantohet këtu ose të tretën në fakt për shpërblimin e tyre që punojnë mirë dhe ndëshkimin e tyre që konsiderohet hapat të cilët gjenden pa saktësinë, cilësinë e punës së tyre , kemi ardhur në një konkluzion sepse janë diku rreth 15.000 a 16.000 mije komisioner afërsisht dhe nëse nuk kemi qenë krejt sigurt sepse nuk e dimë se sa prej tyre do të ketë nevojë , se marrin vendim gjithnjë për të i ndëshkuar dhe sa prej tyre do të meritojnë atë bonus si shpërblim , me thënë të drejtën ideja , edhe një herë po themi kjo është një lloj si të themi vënë theksin në obligimet e tyre për shkak se po të procedohen gjërat sipas doracakut për shkak se si të bëhet procesi i numërimit edhe kodi i mirësjelljes , konsideroj që po të punohet me etikë dhe me mirëbesim atëherë dihet që çdo kush që merret supozohet që merret iu ofrohet një marrëdhënie kontraktuale me KQZ-në në këtë rast si subjekt me qëllim që ta kryej punën me cilësinë e duhur ndërkaq jemi në situatë kur ata çdo komisioner edhe një herë po e përsërisë e nënshkruan kodin e mirësjelljes , në kod të

mirësjelljes i ka parimet pra i ka pikat e caktuara që mos të silozojë e mos u lodh , e ka doracakun, e ka rregullativen ligjor dhe e ka minimumin e asaj që botërisht njihet si kontraktoshesh, ti kontraktoshesh për ta kryer punën sipas një rregullative që të obligonte për të cilës në bazë je trajtuar në një proces të trajnimit megjithatë ne e kemi menduar , jemi të vetëdijshëm që shtypja e kodit të tillë penal ka qenë vetëm një prej ideve të së tillë është dokument relativisht i ngurtë dhe nuk ofron ndoshta ata për të cilën gjithnjë jemi të interesuar dhe kjo për shumë arsye por megjithatë ne jemi fokusuar te kjo deklaratë shtesë që do te bëhet me kryesuesit, dhe kryesuesit të ngarkohen me obligimin që t'i bëjnë me dije, apo ta potencojnë, ta theksojnë rolin dhe përgjegjësinë e komisionerëve që ata kanë. Ndoshta para procesit të numërimit si tërheqje vërejtje, apo si një lloj theksimi i përgjegjësive të tyre.

Ne kemi menduar që kjo deklaratë, shpjegoi z. Halimi, krahas kodit të mirësjelljes që ata tashme e kanë nënshkruar me proces të trajnimit, kjo deklaratë do të shërbejë si një lloj riaktualizimi ta themi, apo një lloj përkujtimi i aty për aty në ditën e zgjedhjeve, apo edhe krejt në fund kur përfundon procesi i votimit ne proces të numërimit t'i lexohet kjo deklaratë dhe t'i merret nënshkrimi nga secili anëtarë nga kryesuesi i vendvotimit. Për këtë kemi kohë mjaftueshëm. Në do t'i shtypim këto, do t'i dizajnojmë me nënshkrim të kryetares së KQZ-së, nëse është me dakordim të plotë. Secili kryesues, secili komisioner dhe këto të ruhen në libër të votimit. \

Eshref Vishaj:Faleminderit, kryetare! Unë ndaj mendimin se sekretariati është vonuar në trajtimin, mos ta quaj problem por shqetësim në vete të cilin e kemi ngritur si anëtarë të KQZ-së. Jemi vonë ndoshta në kuptim të trajnimit të këshillave të vendvotimit me propozimin e dalur nga komisioni, i cili mendoj se do ta ndihmonte dhe forconte transparencë sigurinë dhe saktësinë e numërimit të votave. Nëse ne do të fokusohemi në hapin 2 të doracakut që unë aty ndaj mendimin se kryekëput ka të bëjë me numërimin e votave për subjektet politike dhe për kandidatët. Unë kisha propozuar që të shtohet një verifikues i leximit, një i evidentimit dhe një transparencë më e madhe në futjen e të dhënave në raport. Kjo është vetëm në aspektin teknik. Nuk di sa do ta komplikonte këtë proces në fazën e numërimit të votave. Mirëpo e thash edhe më herët se ndoshta jemi pak vonë për arsye se trajnimet për anëtarë të KVV janë në përfundim e sipër. S`di sa ka mundësi që kryesuesve të iu vihet për detyrë të kenë më tepër qasje në këtë që po propozoj. Unë mendoj që deklarata dhe leximi i saj do ta ndihmonte këtë, njëkohësisht nënshkrimi sidomos në hapjen e vendvotimit momentin e hapjes vendvotimit të lexohet jo vetëm të jepet vetëm për nënshkrim anëtarëve të KKV-së mirëpo para tyre dhe të nënshkruhet në praninë e kryesuesit. Hapi tjetër konkret sa i përket transparencës dhe sigurisë dhe saktësi së numërimit të votave unë prapë mbetem pran propozimit që e dhashë pak më herët, nëse ka hapësirë dhe mundësi vetëm të shtohet nga një verifikues nga një lexues, ata nuk do ta pengojnë vlerësimin fare vetëm do ta sigurojnë që vota që është në këtë votim të evidentohet në raport.

Valdete Daka: Po urdhëro, Ilir...?

Ilir Gashi: Faleminderit. Ne e kemi diskutuar edhe dje këtë çështje, unë po dua të qëndroj ballë asaj çka kam thënë dje edhe si kërkesë, unë po e shoh edhe deklaratën pavarësisht sa i përket

broshurës e këtyre janë të mira që ti përcjellën atyre por , po ndalem te deklaratat sidomos te pika 5 dhe 6 ku mund të zgjerohet në një pikë të vetme. Ne duhet me ju bërë të qartë kryesuesve këtë rrafsh edhe komisionerëve që votat duhet të jetë e normuar edhe këtu, që votat kur numërohen për parti e njëjta procedurë numërohet dhe të zhvillohet për kandidat.

Ne, tha z. Gashi, nuk na intereson sa merr kohë ajo me rëndësi është numërimi me qenë i saktë dhe votën që e ka vu qytetari me qenë ashtu e saktë edhe kur të numërohet. Në qoftë se fletëvotimi kur numërohen votat për kandidat lexohet në prezencën e dy komisioneve qofshin ata të partive të ndryshme dhe mbushet formulari në prezencën e dy tjerëve prapë të ndryshëm kur flas për votat për kandidat të subjekteve politike, atëherë konsideroj se kjo e pamundëson tendencat për manipulim dhe atëherë vetëm në qoftë se do të pajtoheshin të gjithë aty në klasë për me bo parregullsi vetëm atëherë do të kishim tjetërsim të votës së qytetarëve në asnjë variant tjetër jo, duke marr parasysh që edhe vëzhguesit prezent aty, kështu që mos të lihet në emër të kohës që me përfunduar më shpejt, e ai le ti merr të subjektit të tij politik, e ai do ti merr të vetat. Për votat e njëjta procedurë qysh numërohen për parti të njëjtat duhet të numërohen edhe për kandidatë dhe kjo duhet me ju bo e qartë kryesuesve edhe komisionerëve, çdo tendencë për me bo ndryshe do të konsiderohet tendencë për manipulim edhe për shkaktim të veprës penale që do të pasoj edhe me dënime të meritueshme.

Valdete Daka:Ndoshta kish me qenë mirë me vu theksin te kjo deklaratë në ata çka tha Iliri d.m.th që të mos numërohet votat nga ata komisioner e përfaqësuesve të partive politike, pra secili për veti por, nga të gjithë ashtu siç e parasheh edhe ligji dhe në atë udhëzuesin por, t'ju përkujtohet edhe një herë në këtë deklaratë, po më duket që kjo është e gjitha. Po e saktëson, krejt i saktëson, por, ata nuk po i zbatojnë asnjërën për, atë po duhet me ju potencuar edhe njëherë.

Adnan Rrustemi: Së pari unë kam qenë ç'është e vërteta të krijimit të procedurave ose të nxjerrjes së udhëzimeve qarkorëve çfarë do qofshin ato në momente të fundit për shkak se janë krijuar mbase disa rrethana çfarë do qofshin ato të bazuara ose jo. Kjo krijon konfuzitet ma të madh te komisioneri të trupat administrativ i zgjedhjeve në përgjithësi po flas pastaj do të flas konkretisht. Duke mos e ditë nga kundër vështrimi i kondicionerit sepse edhe këtë duhet marr parasysh a po i mbivendoset ky udhëzim mësimëve që kanë marrë gjatë trajnimeve, a po vihet theksi qysh i tha mi zbatuar ato që i kanë mësuar apo po i bëhet ndonjë zëvendësim i ndonjë dispozite apo po krijohet ndonjë metodë e re etj. Duhet me pas një qasje të qëndrueshme si institucion që është konsistente në procesin d.m.th kjo e para, e dyta duhet me pas shumë kujdes mos me quar mesazh te komisionerët jo në mënyrë të drejtë për drejtë por, as në mes rreshtave që vota në mes të subjekteve politike nuk qenka aq e rëndësishme po e rëndësishme qenka brenda listave të kandidatëve të të njëjtit subjekt politik. D.m.th këto nganjëherë edhe në mënyrë të pa vetëdijshme pa qëllim e ki kontraktuar efektin d.m.th duke ja vënë shumë theksin po e zëmë te vota e kandidatëve ti pastaj i thua harro procesin e numërimit të saktë të votave të subjekteve politike. Për mua natyrisht kam thënë edhe në mbledhjet e kaluara vota është e rëndësishme njëjtë si për subjektin ashtu edhe për kandidatin, duhet të sigurohet që shkon në

adresën e duhur por, megjithatë nëse për dikë tash është më e rëndësishme brenda për kandidatët se për subjektin politikë ku ju themi se për mua është më e rëndësishme vota mu u numëruar saktë për subjekt politik se për kandidatin thashë në fillim që është njëjtë ta konkretizojmë. Duhet për mua, mjafton që kjo deklaratë që e paka hartuar sekretariati sa për me rritë nivelin në një shkallë më të lartë.

Doracaku është i qartë, vuri në dukje z. Rrustemi, dhe unë jam kundër për me krijuar tash role të reja brenda këshillit të vendvotimeve përtej asaj që kanë mësuar. Mos të harrojmë edhe një gjë d.m.th ne të gjithë e dimë që e kemi trajnimin shumë të dobët të komisionarëve , tmerrësisht të dobët e kemi edhe kësaj shtate një ndryshim në minutat e fundit të procedurës, për mua është që kemi me dëmtuar edhe ma shumë procesin pastaj. Nuk bënë me ju thënë pastaj në asnjë mënyrë në këtë deklaratë që numëruesit nuk bënë me i numëruar votat e subjektit të tij që i përfaqësojmë. E thotë doracaku krejt çka duhet me ju thënë , ju thash referohuni doracakut kaq është d.m.th krijon paqartësi edhe më të mëdha tash edhe me detajet e vogla mundet plotësuar deklarata , por gjithmonë duke u siguruar që bëhet e zbatueshme. A jam kundër për udhëzim që krijon role të reja procedura të reja dhe detyra të reja për komisionerët pse nuk mbërrin jemi mas trajnimit nuk mbërrin unë jam i sigurt që nuk mbërrin madje veç krijon konfuzitet në publik këto fletëpalosjet për mua janë një gjest i zakonshëm që është mirë me figuruar dhe jo për këtë arsye ish dashtë me qenë pjesë e çdo vendvotimi , pavarësisht kësaj gjëje. Është mirë me i njofto komisionerët cilat janë shkeljet e mundshme dhe cilat janë pasojat ligjore për veprimet e tyre antiligjore në ditën e zgjedhjeve. Madje këtu ka një praktikë. E kemi pas si poster të mëdhenj.

Është mirë, vlerësoi z. Rrustemi që me u vendosë të cilat i kemi vendosur ne vendvotime. Për me konkluduar , çka ka mundësi për me u shpërblyer financiarisht, brenda burimeve financiare që kemi. Për përmbushjen me aktësi të detyrave , jam për zgjidhje brenda ligjit , për mos me krijuar konfuzitetet te komisionerët. Jam kundër çfarë do propozimi që është jashtë procedurës ligjore, siq paska qenë kjo me angazhuar shërbyes civil, por e pashë që janë pajtuar që është e pazbatueshme.

Betim Gjoshi: Ta kemi të qartë, që unë nuk besoj që dikush ka kërkuar procedurë të re. Ka pasur ide se si me dërguar mesazh tek ta. Edhe dje ka abstenuar ide te ndryshme. Ndoshta diku po i mungon. Nuk ka qenë roli që dikush ka menduar që shërbyesit civil me bë numërimin e votave. Ideja ka qenë që me dërguar në llojin e sekretariatit te tyre që me i ndihmuar proceduar realisht për këtë çështje. Nuk është temë diskutimi sot. Sot është temë diskutimi si me gjet mënyrën si me marrë masa me i numëruar saktë votat e subjekteve politike dhe të kandidatëve, dhe askush deri tash nuk i ndajnë. Ndoshta i kanë ndarë në kuptimin e asaj gjatë foljes së tyre, për arsye se kemi pasur probleme me rinumërimet, për arsye te votave të kandidatëve shumë më shpesh se për parti. Te tjera me rëndësi është se , edhe unë propozova , ke theksi që i mungon deklaratës që procedurat do të bëhen , numërimin në përpikshmërin me doracakun. Doracaku i mënjanon të gjitha këto që me i numëruar një person votat e një subjekti politik. Këto i mungojnë deklaratës. Doracaku duhet me iu shtuar. Mendoj që duhet të kushtëzohet çështja e pagesës me nënshkrimin. Duhet me qenë vullnet që me ia transmetuar kryesuesi. Kjo është një shkresë që ia rikujton atyre

që kanë përgjegjësi me kryer detyrat sipas saj. Dhe kryesuesi në fillim të hapjes së vendvotimit duhet me i treguar që duhet me i nënshkruar.

Këto, tha z. Gjoshi, është mirë me i shënuar, për arsye se është e ndërlikur. Me i kthyer në KKZ, për arsye se është e ndërlikur me pagesën. E treta, që desha me thënë është se , ky poster i madh është menduar te jetë në vendvotim. Kështu ka qenë propozimi dje. Ideja ime ke që duhet me e ilustruar, sepse në formën si është nuk do të thotë asgjë. Është një kopje. Kjo është bërë. E keni parë në të gjitha vendet kur shkojmë, që kanë kulturë demokratike, e bëjnë për rikujtim të detyrave që kane të komisionarëve, por edhe të votuesve, sepse votuesi kur hyn e sheh që fotografimi i votës, apo veprimet e tjera janë të ndaluara me ligj. Pra, një zberthye me dy fjalë i asaj që thotë kodi penal. Ndërsa për shpërblimin. Masën është mirë , e marrë një qëndrim që me i shpërblyer të gjithë ato që janë në rregull. Masën e shikojmë në bazë të kursimeve që ka buxheti, dhe si të tilla t'i miratojmë dhe të vazhdojmë më tutje.

Bajram Ljatifi: Në tërësi pajtohem me kolegun Betim se, thelbi i takimit të mbrëmshëm qëndron në atë që të kemi një rezyme, nëse praktika e deritanishme mund të nënkuptohet si dobësi! Ne, me këtë themi se secili përmes apeleve dhe pllakatev ne ua shpjegojmë votuesve se secili vendvotim ka plakatat e caktuara. Nuk do të pajtoheshja që, ne mund t'i tensionojmë anëtarët e komisioneve të vendvotimeve, sepse ata janë të edukuar, madje paraprakisht të edukuar...Ne, nuk mund të themi se ata nuk janë të edukuar, nuk e njohin procesin sepse, ata e njohin procesin...Por, mua më vjen pakëz mërzë që Sekretariati pak brengoset, në fakt ne duhet të mos e dëmtojmë procesin me detale...

Ilir Gashi: Nuk u kuptuam drejtë , e ose pa qëllim. Askush nuk tha që vota për kandidat është më e rëndësishme për subjekt. Të gjeturat tona na kanë treguar që për subjekte politike gjithmonë ka pasur përkushtim të shtuar për me ruajt me fanatizëm votën dhe nuk ka pasur për kandidat, po të njëjtit. Andaj, nuk thanë që votat e kandidatëve nuk bënë t'i numëroj kandidati i partisë përkatëse. Thjeshtë , thanë që procedura e njëjtë , si numërohen votat për parti , të ndiqet edhe për kandidat. Në prezencë, secili fletëvotim ku lexohet në prezencën e tij duhet të jenë së paku dy. Mirë është me qenë të partive të ndryshme. Por te njëjtën kohë, edhe kur të mbushet formulari me qenë edhe vëzhguesit dhe mos me qenë të njëjtit subjekt politik, i cili pastaj është dyshuar që mbi këtë bazë ka krijuar problematikë. Kjo ka qenë arsyeja, dhe të gjitha këto çka u thanë janë pjesë të doracakut. Ne vetëm po dëshirojmë me shtuar me deklaratë.

Eshref Vishaj: U përmend këtu se gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotim me saktësi do të regjistrohet secila votë për subjektin dhe kandidatin. Por, ne shpesh po e përmendim transparencën , dhe e kam një propozim që të futet edhe një pikë këtu që ka të bëjë me transparencën në procesin e numërimit të votave. Kjo është domethënë se nuk e ka kuptimin vetëm të punës drejtë për drejtë të punëtorëve të KVV-së, por edhe vëzhguesve tjerë që kanë mundësi që ta vëzhgojnë procesin e numërimit të votave.

Adnan Rrustemi: E para, nuk është e drejtë që 4 ditë para ditës së zgjedhjeve me u ngritë kjo çështje. Edhe 10 ditë nuk janë serioze për një institucion permanent. I kemi përcjellë disa pale zgjedhje. Këto, ose kanë qenë shqetësime të vazhdueshme, ose janë shqetësime të kësaj situatë. Mendoj që kanë qenë shqetësime të vazhdueshme. Jam kundër që me problematizuar. Jam pro që me u siguruar çdo votë. Jam kundër tash KQZ me u shndërruar në një laborator që i jep përgjigje çdo shqetësimi individual duke e pastrehuar ose neglizhuar procesin zgjedhorë. Le ta sigurojmë procesin. Pajtohem me plotësuar deklaratën me një paragraf që siguron transparencë. Madje ne e kemi futur në rregull që me i siguruar kopje të FPR-ve dhe FRK-ve vëzhguesve dhe komisionarëve. E di që nuk kemi krijuar mekanizma që me i mundësuar një gjë të tillë, por kur e kemi përfshirë e kemi edhe të drejtën dhe mundësi me e fotografuar komisionarët e FPR-së dhe FRK-n. Keni kujdes. Ditën e zgjedhjeve mundet me u paraqitë nevoja për një gjë të tillë. Kjo është ideja me u siguruar transparenca.

Sami Hamiti: Nuk ka qenë kërkesë individuale para KQZ-së, por ka qenë një konsensus i plotë i gjithëve neve. Këtu, para 10 ditëve kur është kërkuar që të gjendet një mënyrë për ruajtjen e votës. Kemi thënë edhe atëherë që mosbarazimi, diferenca për partitë politike 1,2,3, brenda subjekteve, në këtë rast duke përfshirë të gjitha subjektet kanë pasur vërejtje sepse çdo kuti që ka shkuar në rinumërim ka parë që ka devijim shumë të madh të votave brenda subjektit. Unë po shoh, para disa ditëve ishte një kuti e 2010, kishin votuar 500 votues, por votat për kandidat ishin 5000. Një në Obiliq 900 ishte barazimi. Theksi është që gjithmonë në auditim po del që 2, 3 vota. Prej saj del mosbarazimi dhe shkon në auditim për subjektin politik, por për kandidat nëse del 900, në një vend tjetër del 2000, është një shkarje shumë e madhe, dhe nuk po zbulojmë asgjë. Brenda kornizave ligjore po ua bëjmë me dije që ata komisioner as nuk do të hutohen. Nuk po ia ndërrojmë dispozitat ligjore. Po e përkujtojmë. Nuk ka asnjë detyrë të re.

Adnan Rrustemi: Nuk është askush kundër përkujtimit. Jam kundër shtimit të detyrave të reja.

Sami Hamiti: A i kane numëruar deri tash subjektet ndaras për kandidat, sepse kanë thënë nuk po rrinë deri në fund. Ne po duam me ia thënë që e keni për detyrë me qëndruar deri në fund. Kjo është kërkesë e të gjithëve.

Betim Gjoshi: qëllimi është që të shkojmë në vendin e duhur. Unë kam propozuar në kohën kur ka qenë ende pa u miratuar këshillat e vendvotimit para trajnimit. Nuk mundem me marrë barrën e neglizhencës së sekretariatit në mos me vu në theks një çështje që është me rëndësi, që po na sjellë vonesa në certifikim të rezultatit zgjedhorë. Ne kemi propozuar që me i skanuar formularët dhe me i fotografuar, por problemi po ndodh para se me u krijuar formularët. Nuk kemi pasur problem se, formularët janë prishur pastaj! Për këtë arsye, me ia shtuar këtë tekst deklaratës...Edhe çështjen e theksit që duhet me e punuar rend për rend për doracakun gjatë tërë ditës së zgjedhjeve, sidomos në proces të numërimit që është shumë me rëndësi me i përgatitë këto pllakate, konform diskutimeve tona duke ua vënë theksin pikave që ka kodi penal. E treta, me një qëndrim se, kemi me i shpërblyer vendvotimet të cilat nuk kanë probleme në proces të numërimit, i miratojmë dhe vazhdojmë tutje...

Iir Gashi: Kryetare, të dy pikat: njëra flet për proces të numërim të kandidatëve, dhe njëra si proces i numërimit të partive. Më shtuar, të ndiqet procedura e njëjtë...

Betim Gjoshi: Nuk janë të njëjta. Doracak, i ka problemet e ndryshme.

Enis Halimi: Tek 5-shi. Gjatë procesit të numërimit të votave, me saktësi do të regjistrohet secila votë për subjektet politike, sipas doracakut të trajnimit. Edhe tjetrën, sipas doracakut të trajnimit... 3

Valdete Daka: Kush është për...?

Komisioni miratoi këtë pikë të rendit të ditës.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
